



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:291209

Datë: 04.11.2020

Numri i dokumentit: 01244105

PKR.nr.42/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, sipas Kryetares së trupit gjykues, Nushe Kuka Mekaj, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit P.G, për shkak të veprës penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.4 lidhur me nenin 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjën PP.I.nr.242/2019 të dt.29.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.29.10.2020, në prezencë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av.Sevdali Zejnullahu, pa prezencë e Prokurorit të Shtetit, në të njëjtën dite bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.04.11.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **P.G**, nga i ati H. dhe e ëma N., e gjinisë Q., i lindur me..., në..., ku edhe jeton, i martuar, baba i dy fëmijëve, me gjendje të mesme ekonomike, punëtor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.22.11.2020 deri më dt.22.02.2020.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I.

Me dt.20.10.2019 rreth orës 02:50 në restorantin “Amsterdam” që gjendet në fshatin Dobrant K.Graçanicës, i pandehuri me pushkë automatike ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm në atë mënyrë që: pasi që vëllai i të pandehurit P.G, se bashku me bashkëshorten e tij paraprakisht kishin shkuar në atë lokal në gjendje të dehur dhe ishte fjalosur me të dëmtuarin A.D, i cili me telefon e kishte thirrur djalin e axhës së P., A.G dhe e kishte kërkuar nga ai që të shkon dhe të merr P., pasi që i njëjti në gjendje të dehur i kishte shqetësuar mysafirët, pas një kohe në vendin e ngjarjes kanë shkuar i pandehuri P.G, se bashku me vëllain e tij P., ishin futur në lokal dhe kishin qëndruar një kohë dhe në momentin kur kanë filluar të dalin nga lokali, në korridor P.G, në gjendje të dehur, ka filluar që ti shqetësoj mysafirët, duke i sharë dhe shtyrë, i pandehuri P. del në oborr, merr armën automatike nga bagazhi i veturës, deri sa ishte në oborr shtinë 3 herë në ajër, futet në korridorin e lokalit ku shtinë 4 herë brenda në korridor në të cilën kishte numër të madh të personave me ç’rast plagë të rënda trupore kanë pësuar tani të dëmtuarit: Gj.Gj, dy

plagë nën gju dhe një mbi gjurin në këmbën e djathtë, Sh.I në të dy këmbët nën gju dhe lëndime të lehta trupore L.D mbi zogun e këmbës së djathtë.

-Me çka e ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.4 lidhur me nenin 1 të KPRK-së.

II.

I pandehuri nga koha e papërcaktuar e deri me dt.22.11.2019 pa autorizim ka poseduar armën automatike me të cilën e ka kryer veprën penale si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës, e tipit M70 me numër serik 230726 të cilën e ka dorëzuar në polici me një karikator të zbrazët.

-Me çka e ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 17, 38, 39 par.1 pika 1.1, 40 par.1 pika 1.2 dhe 1.3, 42, 43, 69 par.3 lidhur me par.1, pika 3.5, 3.6, 3.7, 79 nenit 356 par.4 lidhur me par.1 dhe 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së, nenet 365, 366, 450, 463 të KPPRK-së, të pandehurin:

GJYKON

Për veprën e penale nën pikën I të këtij aktgjykimi, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, duke i llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.22.11.2019 deri me dt.22.02.2020, dhe

Për veprën penale nën pikën II të këtij aktgjykimi, dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500)€, të cilën gjobë obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri, që në emër shpenzimeve të procedurës penale dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohet i pandehuri si taksa shtesë në emër të programit për kompensimin e viktimave të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së,

KONFISKOHET- arma e tipit M70 me numër serik 230726 dhe një karikator i zbrazët.

URDHËROHET- arma e tipit M70 me numër serik 230726 dhe një karikator i zbrazët, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

Të dëmtuarit Gj.Gj, Sh.I dhe L.D, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Historiku i rastit.

Me dt.29.01.2020, Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngrit aktakuzën nën shenjën nën shenjën PP.I.nr.242/2019 të dt.29.01.2020, kundër të

pandehurit P.G, për shkak të veprës penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.4 lidhur me nenin 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Lënda në punë është pranuar me dt.30.01.2020.

Me dt.29.10.2020, është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë bazuar në dispozitën e nenit 244 të KPPRK-së, është konstatuar se prokurori i shtetit, ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, Kryetarja e trupit gjykues, është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë, duke e udhëzuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, konform dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës i pandehuri P.G, është deklaruar fajtor për veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.4 lidhur me nenin 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit, të cilët janë pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Kryetarja e trupit gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri e bindur se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par.1 pika 1.1 deri në 1.4 të KPPRK-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës siç janë: vërtetimi mbi marrjen e sendeve i dt.22.11.2019, të bëhet shikimi i video incizimeve i bartur në 4 DVD me numër të rastit 2019-AT-0457, mendimi i ekspertit mjekoligjor... i dt.20.01.2020, raporti i ekspertimit me numër të referencës i dt.09.01.2020 dhe nuk është gjetur se aktakuza përmban shkelje të qarta ligjore apo gabime faktike.

Në bazë të pranimit të plotë të fajësisë të të pandehurit P.G, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës të cituara më lartë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.4 lidhur me nenin 1 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar me seancën për caktim të dënimit.

Prokurori i shtetit, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin i ka propozuar gjykatës, që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin. Ndërsa si rrethanë rënduese ka propozuar që të merret shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm.

Mbrojtësi i të pandehurit P.G, av.Sevdali Zejnullahu, ka propozuar që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin pos fajësisë të merr për bazë dhe pendimin e tij të thellë dhe të singertë, premtimin se më nuk do të bie më ndesh me ligjin si dhe faktin se familjet janë pajtuar në mes vete.

I pandehuri P.G, i ka propozuar Gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merren parasysh rrethanat e cituara më lartë nga mbrojtësi, duke shtuar se ajo çfarë ka ndodhur ka qenë rastësisht, ashtu që ka propozuar që ti shqiptohet një dënim më i butë.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 par.3 lidhur me par.1 pika 3.5, 3.6 dhe 3.7 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur në mënyrë publike, më parë i pa dënuar, derisa rrethana rënduese nuk gjeti edhe pse Prokurori i Shtetit, i ka propozuar Gjykatës që si rrethanë rënduese të merret shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm pa dhënë ndonjë arsyeje pse duhet të merret kjo si rrethanë rënduese, ku vetë emërtimit i veprës penale është shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, ndërsa paragrafët të kësaj vepre penale varësisht nga veprimet e kryerjes janë cilësuese dhe për secilin paragraf në fjalë janë të paraparë dhe dënimet.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.1 të KP-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë së tij, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi me të cilin të pandehurit i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, është bazuar në nenin 79 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin, është marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, është marrë në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit.NR.05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.42/20

Bashkëpunëtore profesionale
Elzana Kastrati

Kryetarja e trupit gjykues
Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.